

|                                                                                   |                                                                                                                                                  |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b><br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVA<br><b>KOMUNA E RAHOVECIT</b><br>OPSTINA ORAHOVAC<br>MUNICIPALITY OF RAHOVEC |  |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|

|               |                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------|
| <b>Për:</b>   | Operatorin Ekonomik: "EOR GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë    |
| <b>Nga:</b>   | Astrit Mullabazi – U.D. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës                           |
| <b>Datë:</b>  | 03.05.2019                                                         |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 30.04.2019, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "EOR GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, nxjerr:

## VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar e Operatorit Ekonomik: "EOR GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, kundër Njoftimit për Kontratë të AK – së, të datës: **25.04.2019**, të publikuar në web – faqe të KRPP – së.
- II. **ANULOHET** tërësisht Vendimi i miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, dhe i njejti aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
U.D.Menaxher i Zyres se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit

